

**BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

**Raporti i audituesit të pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare në datën dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

## PËRMBAJTJA

### Contents

#### RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT	3
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	4
1. TË PËRGJITHSHME	5
2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA	5
2.1 STANDARDE DHE INTERPRETIME NË FUQI NË PERIUDHËN RAPORTUESE .....	5
2.2 STANDARDE DHE INTERPRETIME TË PUBLIKUARA, QË NUK JANË AKOMA NË FUQI DHE AS TË APLIKUARA	6
3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL	8
4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	18
5. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ	19
6. SHUMAT E KUSHTËZUARA ME BANKËN QËNDRORE	19
7. HUA DHE PARAPAGIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE	20
8. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE	20
9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT, NETO	22
10. AKTIVET E TRUPËZUARA, NETO	25
11. AKTIVET E PATRUPËZUARA, NETO	26
12. AKTIVET E MBAJTURA PËR SHITJE	26
13. AKTIVE TË MARRA NË PRONËSI NGA ÇËSHTJE GJYQËSORE	26
14. AKTIVET E TJERA	27
15. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE	27
16. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	29
17. DETYRIME TË TJERA	31
18. DETYRIME TATIMORE TË SHTYRA, NETO	31
19. KAPITALI I PAGUAR	31
20. ANALIZA E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE DHE KAPITALIT SIPAS MATURITETIT	32
21. TË ARDHURA NGA INTERESI	33
22. SHPENZIME PËR INTERESA	33
23. TË ARDHURA NGA KOMISIONET	33
24. SHPENZIME PËR KOMISIONET	33
25. ZHVLERESIME DHE FSHIRJE NGA LIBRAT	33
26. SHPENZIME PERSONELI	34
27. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE	34
28. TATIMI MBI FITIMIN	34
29. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA	35
30. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA	36
31. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT	37
32. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR	38



Ernst & Young Certified Auditors  
Albania Branch  
NUIŠ: K619110121  
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6<sup>th</sup> floor  
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575  
ey.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve të Bankës Societe Generale Albania sh.a

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Societe Generale Albania sha (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2016, dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës Societe Generale Albania sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

31 mars 2017  
Tiranë, Shqipëri

*Ernst & Young Certified Auditor*



Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

*Mario Vangjel*

# BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.


(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)


## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Aktivet</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	7,104,355	3,005,695
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	6	5,986,772	5,605,130
Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare	7	1,313,232	1,291,240
Investime të vlefshme për shitje	8	19,622,279	19,995,349
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	9.1	44,761,531	40,536,932
Qiratë financiare	9.2	688,226	592,504
Aktive të mbajtura për shitje	12	104,314	-
Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore	13	582,170	1,125,712
Aktive të tjera	14	319,258	325,675
Aktive të trupëzuara, neto	10	498,838	559,433
Aktive të patrupëzuara, neto	11	240,945	240,132
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>81,221,920</b>	<b>73,277,802</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	7,629,534	4,940,172
Detyrime ndaj klientëve	16	64,199,730	59,496,585
Detyrime të tjera	17	412,596	351,749
Detyrime që lidhen me aktivet e mbajtura për shitje	12	25,221	-
Detyrime ndaj tatimit të shtyrë	18	75,392	9,609
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>72,342,473</b>	<b>64,798,115</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	19	6,740,900	6,740,900
Primi i aksioneve		1,750	1,750
Rezerva ligjore dhe të tjera		95,614	4,618
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	8	492,795	103,705
Fitimi i pashpërndarë		1,548,388	1,628,714
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>8,879,447</b>	<b>8,479,687</b>
<b>Totali detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>81,221,920</b>	<b>73,277,802</b>

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 63 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 31 Mars 2017 dhe janë firmosur nga:

  
**Frederic Blanc**  
Drejtor i Përgjithshëm

  
**Albana Hallvaxhiu**  
Drejtore e Finance

**BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.***(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)***Pasqyra të ardhurave gjithpërfshirëse  
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga interesat	21	3,399,634	3,601,017
Shpenzime për interesat	22	(557,592)	(758,898)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>2,842,042</b>	<b>2,842,119</b>
Të ardhura nga komisionet	23	486,649	411,424
Shpenzime për komisionet	24	(78,952)	(69,810)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>407,697</b>	<b>341,614</b>
Fitimi nga kurset e këmbimit (Humbja)/Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		85,544 (5,314)	78,255 96
Humbje të tjera, neto		(4,136)	(13,263)
Humbje nga shitja e aktiveve të marra në pronësi nga çështje gjyqësore		(66,330)	-
<b>Të ardhura të tjera operative</b>		<b>9,767</b>	<b>65,088</b>
Zhvlerësime dhe fshirje llogarish të tjera	25	(1,068,912)	(1,176,720)
Zhvlerësimi i aktiveve të trupëzuara	10	(84,199)	(87,312)
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	11	(54,014)	(47,389)
Shpenzime personeli	26	(702,377)	(680,547)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(894,835)	(921,003)
		<b>(2,804,337)</b>	<b>(2,912,971)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>455,169</b>	<b>335,850</b>
Tatim mbi fitimin	28	(87,256)	(82,300)
Tatim i shtyrë	18	(65,783)	(9,609)
<b>Fitimi i vitit, neto</b>		<b>302,130</b>	<b>243,941</b>
<b>Të ardhura gjithpërfshirëse</b>			
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për tu riklasifikuar në humbje dhe fitim në periudhat e ardhshme</i>			
· Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje		389,090	52,816
		<b>389,090</b>	<b>52,816</b>
<b>Të ardhura gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>389,090</b>	<b>52,816</b>
<b>Totali i pasqyrës gjithpërfshirëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin, neto</b>		<b>691,221</b>	<b>296,757</b>

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 63 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

**BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.***(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në kapital  
më 31 dhjetor 2016**

	<b>Kapitali i paguar</b>	<b>Primi i aksioneve</b>	<b>Rezerva ligjore dhe te tjera</b>	<b>Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2015</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>4,618</b>	<b>50,889</b>	<b>1,384,773</b>	<b>8,182,930</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	243,941	<b>243,941</b>
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	52,816	-	<b>52,816</b>
<b>Të ardhura gjithpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>52,816</b>	<b>243,941</b>	<b>296,757</b>
Kapitali i nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividentë të paguar	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>4,618</b>	<b>103,705</b>	<b>1,628,714</b>	<b>8,479,687</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	302,130	<b>302,130</b>
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	389,090	-	<b>389,090</b>
<b>Të ardhura gjithpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>389,090</b>	<b>302,130</b>	<b>691,221</b>
Kapitali i nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividentë të paguar	-	-	-	-	(291,460)	<b>(291,460)</b>
Rezerva rregullative dhe ligjore	-	-	90,996	-	(90,996)	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>95,614</b>	<b>492,795</b>	<b>1,548,388</b>	<b>8,879,447</b>

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 63 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

**BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.***(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)***Pasqyra e flukseve të parasë  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Rrjedha e parasë nga operacionet:</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>455,169</b>	<b>335,850</b>
<i>Rregullime për të kuadruar rezultatin neto me rrjedhjen neto të aktiveve monetare nga veprimtaritë operative:</i>			
Zhvlërësimi i aktiveve të trupëzuara	<b>10</b>	84,199	87,312
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	<b>11</b>	54,014	47,389
Zhvlërësimet dhe fshirje llogarish të tjera	<b>25</b>	929,504	1,176,720
Zhvlërësimet mbi aktivet e marra në rrugë ligjore		134,584	-
Humbja /(Fitimi) nga shitja e aktiveve të trupëzuara		5,314	(96)
Humbje nga shitja e aktiveve të marra në rrugë ligjore		66,330	-
Të ardhura nga interesat	<b>21</b>	(3,399,634)	(3,601,017)
Efekti nga ndryshimi i kursit të këmbimit		36,769	57,938
Shpenzime për interesat	<b>22</b>	557,592	758,898
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>(1,076,159)</b>	<b>(1,137,006)</b>
<i>Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:</i>			
(Rritja)/pakësim në shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore		(381,193)	151,872
(Rritje) në huatë dhënë institucioneve financiare		(19,664)	(103,404)
(Rritje) në hua dhe paradhënie për klientët		(5,217,816)	(3,151,879)
Pakësim / (rritje) në aktive të tjera		244,731	(304,912)
Rritje në detyrimet ndaj institucioneve financiare		2,656,212	918,179
Rritje në detyrimet ndaj klientëve		4,545,369	423,055
Rritje /(pakësim) në detyrime të tjera		126,629	(67,404)
Rritja në detyrime të lidhura me aktive të mbajtura për shitje		25,221	-
Interesi i arkëtuar		3,432,062	3,595,245
Interesi i paguar		(366,666)	(589,241)
Tatim fitimi i paguar		(153,039)	(99,585)
<b>Paraja neto e gjeneruar /(përdorur) nga aktiviteti operativ</b>		<b>3,815,687</b>	<b>(365,081)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese:</b>			
Blerje e letrave me vlerë neto me shitjet		(4,047,566)	(11,459,171)
Maturimi i letrave me vlere		4,705,743	11,956,979
Blerje e aktiveve të patrupëzuara		(11,561)	(3,772)
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(85,438)	(113,531)
Pakësimet nga aktivet e trupëzuara		13,254	827
<b>Paraja neto e gjeneruar nga veprimtaritë investuese</b>		<b>574,433</b>	<b>381,332</b>
<b>Para neto të gjeneruara nga veprimtaritë financuese:</b>			
Pagesa e dividendit		(291,460)	-
<b>Paraja neto e gjeneruar nga veprimtaritë financuese</b>		<b>(291,460)</b>	<b>-</b>
<b>Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>		<b>4,098,660</b>	<b>16,251</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>		<b>3,005,695</b>	<b>2,988,764</b>
<b>Ndikimi i ndryshimit të kursit të këmbimit në para dhe ekuivalentët e saj</b>		<b>-</b>	<b>680</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>		<b>7,104,355</b>	<b>3,005,695</b>

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 63 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.



## **1. Të përgjithshme**

Banka Societe Generale Sh.a (“Banka”) është një institucion financiar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe u liçencua nga Banka e Shqipërisë më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 “Mbi sistemin bankar në Shqipëri”, i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, “Mbi Bankën e Shqipërisë”. Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. Bazuar në marrëveshjen e blerjes së aksioneve të datës 18 prill 2007, Societe Generale bleu 75.01% të aksioneve të Bankës dhe rriti përqindjen e saj në 88.64%.

Më 21 gusht 2009 Banka krijoi filialin e saj “Sogelease Albania sh.a” të cilin e zotëronte plotësisht. Më 31 Mars 2015 Banka dhe Sogelease Albania u bashkuan në një institucion të vetëm me emrin Banka Societe Generale Albania.

Më 31 dhjetor 2016, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 37 degëve të saj (2015: 39 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2016 Banka kishte 410 punonjës (31 dhjetor 2015: 395 punonjës).

## **2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara**

### **2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese**

#### **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit**

Ndryshimet qartësojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 që të ardhurat që pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të krijuara nga aktivitetet e një kompanie (në të cilin pasuria është pjesë) sesa përfitimet ekonomike që janë konsumuar nëpërmjet përdorimit të pasurisë. Si rezultat, një metodë e bazuar në të ardhura nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe paisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e pasurive të patrupëzuar aktive. Ndryshimet janë në fuqi në mënyrë prospective për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershme të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në Bankën e dhënë se Banka nuk ka përdorur një metodë të bazuar në të ardhurat për të zhvlerësuar pasuritë e saj afatgjata.

#### ***Përmirësimet vjetore Cikli 2012-2014***

Këto përmirësime janë të aplikueshme për periudhat më apo pas 1 janar 2016. Këto përmirësime përfshijnë:

#### **SNRF 5 Pasuritë Jo - qarkulluese që mbahen për shitje dhe operacionet e ndërprera**

Pasuritë (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit) në përgjithësi asgjësohen ose nëpërmjet shitjes apo shpërndarjes ndaj pronarëve. Ndryshimi sqaron se ndryshimi në asgjësim nga një metodë në tjetrën nuk duhet të konsiderohet të jetë një plan i ri për asgjësim, por si një vazhdim i planit origjinal.

#### **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpalosjet**

##### **(i) Kontratat e Shërbimit**

Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme të një pasurie financiare. Një kompani duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe rregullimin kundër udhëzimit të përfshirjes së vazhdueshme në SNRF 7 në mënyrë që të vlerësohet nëse shpalosjet e informacioneve shpjeguese janë të nevojshme.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

## **2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

### **2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)**

#### **(i) Kontratat e Shërbimit (vazhdim)**

Vlerësimi i kontratës të shërbimit përbën përfshirjen e vazhdueshme që duhet bërë në mënyrë retrospektive. Megjithatë, shpalosjet e kërkuara nuk do të duhet të sigurohen për çdo periudhë që fillon para periudhës vjetore në të cilën kompania i zbaton ndryshimet së pari.

#### **(ii) Zbatimi i ndryshimeve të SNRF 7 për Pasqyrat e Ndërmjetme Financiare të Konsoliduara**

Ndryshimi sqaron se kërkesat për kompensim në dhënien e informacioneve shpjeguese nuk zbatohen për pasqyrat e ndërmjetme financiare të konsoliduara, përveç nëse shpalosjet e tilla sigurojnë një përditësim të rëndësishëm në informacionin e raportuar në raportin vjetor më të fundit. Banka nuk i përgatitë pasqyrat e ndërmjetme të konsoliduara.

### **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve**

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, normat e bonove qeveritare duhet të përdoren. Ndryshimi aplikohet në mënyrë prospektive.

- SNK 34 Raportimi Financiar për Interim;
- SNFR 14 Kontot e Shtyra të Rregullatorit;
- Ndryshimet në SNFR 11 Marrëveshjet e Përbashkëta: Kontabiliteti për marrjen e interesave;
- Ndryshimet në SNK 27: Metoda e Ekuitetit në Pasqyrat e Veçanta Financiare

### **2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara**

Standardet e publikuara, por që nuk janë akoma në fuqi dhe as nuk janë aplikuar hershëm nga Banka janë listuar më poshtë. Ky listim përmban standarde dhe interpretime të publikuara, për të cilat Banka pret të kenë ndikim në shënimet shpjeguese, pasqyrën e pozicionit financiar, performancë kur të aplikohen në një datë të ardhshme. Banka ka qëllim t'i aplikojë standardet kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë të aplikueshme në Banka nuk janë të diskutuara në detaje.

### **SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë. KIRFN 4 përcakton nëse një marrëveshje përmban një marrëveshje qiraje. KIS-15 Qeratë Operative- Nxitjet dhe KIS 27 Vlerësimi i Përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e qirave. Gjithashtu kërkon nga qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë në një model të vetëm në bilancin e gjendjes të ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy sqarime për qiratë- qiraja “me vlerë të ulët” (psh. kompjuter), dhe qiraja “afat-shkurtër” (qiratë me afat 12 muaj ose më pak). Në ditën e marrëveshjes për qira, qiramarrësi do të njohë detyrimin për pagesë të qirasë (detyrimi për qira) dhe një pasuri që paraqet të drejtën për shfrytëzimin e qirasë për periudhën kohore të përcaktuar në kontratë (p.sh.,e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësit do t'i kërkohej të njohë veçmas shpenzimet e interesit mbi qiranë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

**2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)**

**SNRF 16 Qiratë (vazhdim)**

Qiramarrësi do ti duhet të rimatë detyrimin e qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rezulton nga një ndryshim në një indeks ose normë që përdoret për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rimatjes së detyrimit të qirasë si një rregullim për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb pandryshuar nga kontabilitetin i sotëm sipas SNK 17. SNRF 16 kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të bëjnë shpalosje më të gjërë sipas SNK 17.

SNRF 16 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019. Aplikimi i hershëm është i lejuar, por jo para se njëzia ekonomike të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të zgjedh për të aplikuar standarde duke përdorur ose një retrospektivë të plotë apo një qasje të modifikuar retrospektiv. Dispozitat kalimtare të standardi lejojnë disa lehtësira të caktuara. Në vitin 2017, Banka ka në plan për të vlerësuar efektin e mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

***SNRF 9 Instrumentat Financiarë***

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 bashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, dëmtimin dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Përveç për kontabilitetin mbrojtës, zbatimi retrospektiv kërkohet, por sigurimi i informacionit krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat janë aplikuar në përgjithësi në mënyrë prospektive, me disa përjashtime të kufizuara.

Banka ka në plan të miratojë standardet e reja në datën efektive të kërkuar. Banka është në procesin e kryerjes të një niveli të lartë për vlerësimin e ndikimit të të gjitha tre aspekteve të SNRF 9. Vlerësimi paraprak është i bazuar në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që rrjedhin nga analiza të mëtejshme të hollësishme ose informacione shtesë të arsyeshme që mund të vihen në dispozicion të Bankës në të ardhmen.

***(a) Klasifikimi dhe Matja***

Banka nuk pret ndikim të rëndësishëm në bilancin e saj apo në ekuitet, nga zbatimi i kërkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen. Ajo pret që të vazhdojë të përdorë vlerën e drejtë në matjen e të gjitha pasurive financiare të cilat aktualisht mbahen me vlerën e drejtë.

Kreditë si dhe të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritjet të japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit përveç kredive në vonesë prej të cilave rrjedhet monetare për bankën do vijnë nga shijta e kolateralit. Kështu, Banka pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, Banka do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të vijë në përfundimin se të gjitha këto instrumente kanë përmbushur kriteret për matjen koston së amortizuar sipas SNRF 9.

***(b) Zhvlerësimi***

SNRF 9 kërkon që Banka të regjistrojë humbjet e pritshme të letrave me vlerë, kredive dhe të arkëtueshmeve tjera, , mbi një bazë 12-mujore ose gjatë tërë ekzistencës së saj. Banka do të duhet të bëjë një analizë më të detajuar e cila merr në konsideratë të gjitha informatat e arsyeshme dhe të mbështetura, duke përfshirë elementet largpamëse për të përcaktuar shkallën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

#### **2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

##### **2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)**

###### ***SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)***

###### ***(c) Kontabiliteti mbrojtës***

Banka beson se të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse ekzistuese të cilat janë aktualisht të përcaktuara si marrëdhënie mbrojtëse do të vazhdojnë të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Sikur se SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme se si një njësi ekonomike kontabilizon mbrojtjet efektive, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

###### ***SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët***

SNRF 15 është publikuar në maj 2014 dhe përcakton një model pesë-hapësh për të llogaritur të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientët. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një shumë që pasqyron vlerësimin për të cilin Banka pret t'ia njoh në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve një klienti.

Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale për njohjen e të ardhurave sipas SNRF-ve. Ose një aplikim i plotë retrospektiv ose një aplikim retrospektiv i modifikuar është i nevojshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 kur BSNK përfundon ndryshimet e tyre për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 për një vit. Miratimi i hershëm është i lejuar. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga SNRF 15.

###### ***SNK 7 Iniciativa e Shpalosjes - Ndryshimet në SNK 7***

Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme janë pjesë e iniciativës të BSNK-së për shpalosje dhe kërkojnë që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese që i mundësojnë përdoruesit të pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare, duke përfshirë të dy ndryshimet që rrjedhin nga flukset e parave të gatshme dhe ndryshimet nga paratë jo të gatshme. Në aplikimin fillestar të ndryshimit, subjektet nuk janë të detyruara të sigurojnë informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017, me aplikimin e hershëm të lejuar.

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël**

##### **(a) Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

##### **(b) Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç investimeve të vlefshme për shitje.

##### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare të veçanta paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës.

##### **(d) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(d) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit për aktivet monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

##### **(e) Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse në bazë të metodës së interesit efektiv.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe rishikohet në çdo datë riçmimi.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi baza të interesit efektiv.

##### **(f) Tarifa dhe komisione**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Tarifat e angazhimet të kredisë për kredi që ka të ngjarë të zvogëlohen dhe pagesa të tjera të lidhura kredinë shtyhen (së bashku me çdo kosto rritëse) dhe njihen si një rregullim të normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

##### **(g) Pagesat e qirasë operative**

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetëgjatësisë së qirasë.

##### **(h) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

##### **(i) Planet e pensioneve me përfitim të përcaktuar**

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione.

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(j) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e pozicionit financiar, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar, dhe bazës së tyre tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë në datën e raportimit. Detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjithë diferencat e përkohshme të tatueshme.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

Tatime të tjera mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët përkatës.

**(k) Aktivitet dhe detyrimet financiare**

**(i) Njohja**

Banka njeh huatë, parapagimet dhe depozitat me kosto në datën kur i lind e drejta e detyrimit. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet financiare të tjera njihen në datën e tregëtimit, datë në të cilën Banka bëhet palë e kontratës.

**(ii) Ç'regjistrimi**

Aktivitet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktore të Bankës ndaj rrjedhjeve monetare që vijnë nga aktivi financiar mbarojnë ose nëse Banka i transferon aktivin financiar një pale tjetër bashkë me kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitet. Çdo interes në aktive financiare të transferueshme që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen nga Banka nëse detyrimet kontraktuale të Bankës mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitet të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitet e transferuara nuk ç'regjistrohen nga pasqyra e pozicionin financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitet i shiten një pale të tretë, dhe Banka përfshihet në një transaksion shkëmbyes për të njëjtin aktiv me një normë kthimi përafërsisht të njëjtë, transaksioni rregjistrohet si një transaksion financiar i ngjashëm me transaksionet e riblerjeve. Në transaksione në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitet financiare, Banka e ç'regjistron aktivin nëse e humbet kontrollin mbi aktivin.

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(k) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

###### **(ii) Ç'regjistrimi (vazhdim)**

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Gjithashtu Banka i ç'regjistron disa aktive kur këto balanca gjykohen të parikuperueshme (shiko shënimi4).

###### **(iii) Prezantimi me bazë neto**

Banka nuk neton aktive dhe detyrime ose të ardhura dhe shpenzime, përveçse nese kërkohet ose lejohet nga SNRF. Gjithashtu, Banka paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i ngjashëm transaksionesh për shembull fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore. Megjithatë, Banka mund t'i paraqesë të tilla fitime ose humbje në mënyrë individuale në qoftë se ato janë materiale.

###### **(iv) Matja e kostos së amortizuar**

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

###### **(v) Matja e vlerës së drejtë**

Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar në tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregëtueshme në tregje aktive. Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Per të përcaktuar vlerën e drejtë, Banka përdor hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura për llogaritjet:

Niveli 1: Çmimi i kuotuar në treg (i pa rregulluar), në një treg aktiv për një instrument të njëjtë.

Niveli 2: Metodat e vlerësimit të bazuar në të dhënat e vëzhgueshme direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet).

Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotura në tregje aktive për instrumente të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose metoda të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyre direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: Metodat e vlerësimit që përdorin të dhëna të rëndësishme jo të vëzhgueshme.

Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna të rëndësishme të cilat nuk mund të vëzhgohen, dhe këto të dhëna kanë efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumenteve. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmimin e kuotuar të instrumenteve të ngjashëm, çmim i rregulluar bazuar në të dhëna të pavëzhgueshme ose supozime të tjera për të reflektuar diferencat ndërmjet instrumenteve që vlerësohen dhe instrumenteve të kuotuar.

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(k) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

**(v) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)**

Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrijnë të përcaktojnë një vlerë të drejtë që pasqyron çmimin e instrumenteve financiare në datën e raportimit, e cila do të ishte përcaktuar nga pjesmarrësit e tregut që veprojnë si transaksione normale.

**(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit**

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ekzistojnë evidenca objektive që një ngjarje që sjell humbje, ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Banka i zhvlerëson aktivet e saj individualisht dhe gjithashtu në grup. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme analizohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Të gjitha aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme analizohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë, mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës ose një emetues borxhi po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh. ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi ose huadhënësi në Bankë ose kushtet ekonomike që mund të sjellin vonesa në pagesa ndaj Bankës.

Për përcaktimin e zhvlerësimit në grup, Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje pasqyrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse .

**(l) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve afatshkurtra.

**(m) Huatë dhe paradhëniet**

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht njihen me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.



### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(n) Letrat me vlerë**

Investimet në letra me vlerë maten me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohen sipas klasifikimit si të mbajtura deri në maturim ose të mbajtura për shitje.

#### **(i) Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim**

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka për qëllim t'i mbajë deri në maturim të cilat nuk mbahen në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose nuk klasifikohen si të vlefshme për shitje. Ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim me vlerë të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

#### **(ii) Letrat me vlerë të mbajtura për shitje**

Investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare.

Investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera përmbledhëse sipas metodës së interesit efektiv. Të ardhurat / humbjet nga këmbimet valutore të letrave me vlerë të mbajtura për shitje regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Fitimet apo humbjet nga një aktiv financiar i vlefshëm për shitje njihen tek pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, përveç humbjeve nga zhvlerësimi dhe fitimeve dhe humbjeve nga kurset e këmbimit derisa aktiv i financiar çregjistrohet. Fitimet dhe humbjet e mbajtura deri në momentin e ç'rrgjistrimit në të ardhurat përmbledhëse, riklasifikohet nga kapitali në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Gjithsesi, interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera përmbledhëse.

#### **(o) Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet Jo të Vijueshme**

Aktivitet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje të maten me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Një njësi ekonomike klasifikon një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje nëse vlera e tij kontabël (neto) do të rifitohet parimisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm.

Nëse ky është rasti, aktivitet (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të jetë i përshtatshëm për shitje të menjëhershme në kushtet e tij aktuale subjekt vetëm për kushtet që janë të përdorshme dhe të zakonshme për shitjet e aktiveve të tilla (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) dhe shitja e tij duhet të jetë me probabiliteti të lartë për t'u realizuar brenda një viti.

Një operacion jo i vijueshëm cilesohet si i tillë në rast se është një përbërës i njësisë ekonomike që ose është nxjerrë jashtë përdorimit, ose është klasifikuar si i mbajtur për shitje, dhe:

- (a) përfaqëson një linjë kryesore të ndarë veças të biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh,
- (b) është pjesë e një plani të vetëm të koordinuar për të nxjerrë jashtë përdorimit një linjë kryesore të ndarë veças të biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh ose
- (c) është një filial i blerë ekskluzivisht me qëllim për t'u rishitur.

Aktivitet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje të paraqiten veças në pamjen e parë të pasqyrës e pozicionit financiar dhe rezultatet e veprimtarive të ndërprera të paraqiten veçmas në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(p) Aktivet e trupëzuara**

###### **(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

###### **(ii) Kostot vijuese**

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse në momentin kur ndodhin.

###### **(ii) Amortizimi**

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo pjesë të një aktivi të trupëzuar. Përmirësimet e bëra në aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	<u>(në vite)</u>
Ndërtesa	30
Kompjutera dhe pajisje informatike	5
Instalime dhe pajisje të tjera	5
Pajisje zyre	10
Automjete	5
Investime në mjetet e marra me qira	5

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proces.

##### **(q) Aktivet e patrupëzuara**

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të fitimit ose humbjes, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është dhjetë vjet.

##### **(r) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme.

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(q) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare (vazhdim)**

Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të mjeteve monetare skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

##### **(r) Depozita dhe detyrime të tjera financiare**

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet e borxhit si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### **(s) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që nxjerrje fondesh do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

Provizionet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme rrezikun specifik të detyrimit.

##### **(t) Paraqitja e vlerës së drejtë**

*Hua dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve financiare*

Huatë dhe paradhëniet dhënë bankave dhe institucioneve financiare përfshijnë vendosjet ndërbankare. Vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë përafërsisht e njëjtë me vlerën e tyre kontabël.

*Hua dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve financiare*

Huatë dhe paradhëniet dhënë bankave dhe institucioneve financiare përfshijnë vendosjet ndërbankare. Vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë përafërsisht e njëjtë me vlerën e tyre kontabël.

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### (u) Paraqitja e vlerës së drejtë (vazhdim)

###### *Hua dhe paradhënie për klientët*

Huatë dhe paradhëniet paraqiten neto me fondin e provizionimit. Portofoli i huave të bankës ka një vlerë të drejtë të përafërt me vlerën e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afat-shkurtër ose të normave të interesit, të cilat i përafrohen atyre të tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i riçmimit brenda një viti me përjashtimin e një grupi kredie të dhënë në vitin 2008, i cili është dhënë pa një cmim dysHEME të aplikueshëm.

###### *Detyrime të tjera ndaj bankave dhe klientëve*

Vlera e drejtë e depozitave me afat përfron me vlerën kontabël për shkak të natyrës së tyre të maturimit afatshkurtër, me përqëndrimin e depozitave duke qene brenda grupit (0 deri në 1 viti)

Tabela ne vijim përmbledh vlerën e drejtë të instrumentave financiare sipas klasifikimit të tyre në bilanc:

Aktivet dhe pasivet financiare	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë
<b>Aktivet financiare</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7,104,355	7,104,355	3,005,695	3,005,695
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	5,986,772	5,986,772	5,605,130	5,605,130
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,313,232	1,313,232	1,291,240	1,291,240
Investime të vlefshme për shitje	19,622,279	19,622,279	19,995,349	19,995,349
Aktive të mbajtura për shitje	104,314	126,170	-	-
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	44,761,531	45,203,481	40,536,932	40,565,444
Qiratë financiare	688,226	688,226	592,504	592,504
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>79,580,709</b>	<b>80,044,514</b>	<b>71,026,850</b>	<b>71,055,362</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Kredi dhe paradhënie nga institucionet financiare	7,629,534	7,629,534	4,940,172	4,940,172
Detyrime ndaj klientëve	64,199,730	63,978,122	59,496,585	59,496,585
Detyrime që lidhen me aktivet e mbajtura për shitje	25,221	25,221	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>71,854,485</b>	<b>71,632,877</b>	<b>64,436,757</b>	<b>64,436,757</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### (u) Paraqitja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të gjithë instrumentat financiarë janë matur me kosto te amortizuar, me përjashtim të investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje dhe aktiveve të mbajtura për shitje të cilat janë matur me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 për investimet në letrat me vlerë mbajtur për shitje është matur bazuar në nivelin 2 të hierarkisë.

	31 dhjetor 2016					31 dhjetor 2015				
	Vlera e mbartur	Kosto e amortizuar	Vlera e drejtë			Vlera e mbartur	Kosto e amortizuar	Vlera e drejtë		
			Nivel 1	Nivel 2	Nivel 3			Level 1	Level 2	Level 3
<b>Aktive</b>										
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7,104,355	7,104,355	-	-	-	3,005,695	3,005,695	-	-	-
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	5,986,772	5,986,772	-	-	-	5,605,130	5,605,130	-	-	-
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,313,232	1,313,232	-	-	-	1,291,240	1,291,240	-	-	-
Investime të vlefshme për shitje	19,622,279	-	-	19,622,279	-	19,995,349	-	-	19,995,349	-
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	44,761,531	-	-	-	45,203,481	40,536,932	40,536,932	-	-	-
Qiratë financiare	688,226	688,226	-	-	-	592,504	592,504	-	-	-
Aktive mbajtur për shitje	104,314	-	-	126,170	-	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	319,258	319,258	-	-	-	325,675	325,675	-	-	-
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>79,899,967</b>	<b>15,411,843</b>	-	<b>19,748,448</b>	<b>45,203,481</b>	<b>71,352,526</b>	<b>51,357,177</b>	-	<b>19,995,349</b>	-
<b>Detyrime</b>										
Kredi dhe paradhënie nga institucionet financiare	7,629,534	7,629,534	-	-	-	4,940,172	4,940,172	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	64,199,730	-	-	-	63,978,122	59,496,585	59,496,585	-	-	-
Detyrime të tjera	487,988	487,987	-	-	-	361,358	361,358	-	-	-
Detyrime lidhur me aktivet për tu shitur	25,221	25,221	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>72,342,473</b>	<b>8,142,742</b>	-	-	<b>63,978,122</b>	<b>64,798,115</b>	<b>64,798,115</b>	-	-	-

**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )*

---

**4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Drejtimi i Bankës ka diskutuar me Bordin Drejtues zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar në qoftë se rishikimi prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon njëkohësisht në peridhën raportuese dhe në periudhat e ardhshme. Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 32).

**Burimet kryesore të pasigurisë në matje**

***Zhvlerësimet për humbje nga kreditë***

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimeve të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë nga Drejtimi të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar vlerësohet bazuar mbi cilësitë e tij dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga Departamenti i Riskut.

Fondi i zhvlerësimit për kreditë në grup mbulon humbjet nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv drejtimi konsideron faktorë si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimin si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar janë bërë supozime për të përcaktuar sesi janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të provizionit varet nga sa të matshme janë rrjedhjet e ardhshme të projektuara dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 5. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Arka		
Në Lek	764,677	551,017
Në monedhë të huaj	514,463	425,031
Llogari rrjedhëse me Bankën Qëndrore	232,596	5,513
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	4,756,699	877,839
Vendosjet në tregun e parasë	835,920	1,146,295
<b>Totali</b>	<b>7,104,355</b>	<b>3,005,695</b>

Norma e interesit vjetor për depozitat me afat me bankat rezidente gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 variojnë nga 0.25% në 1.80% (2015: 0.20% në 2.35 %) dhe për depozitat me afat me bankat jo-rezidente nga 0.05% në 0.75% (2015: 0.04% në 0.48%).

Llogaritë rrjedhëse me bankat në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të detajuara gjeografikisht janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Austri	679,343	1,500
Francë	3,933,585	571,756
Shqipëri	158	617
Gjermani	-	279,482
Zvicër	12,476	5,655
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	118,559	7,984
Britani e Madhe	12,578	10,845
<b>Totali</b>	<b>4,756,699</b>	<b>877,839</b>

Vendosjet në tregun e parasë në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të detajuara gjeografikisht janë si më poshtë dhe maturiteti i tyre varion nga 5-8 ditë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shqipëri	450,033	-
France	385,887	978,362
Austri	-	167,933
<b>Totali</b>	<b>835,920</b>	<b>1,146,295</b>

#### 6. Shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore lidhur me depozitën rezervë, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve pranë Bankës Qëndrore si llogari rezervë.

Interesat mbi rezervën statusore në Bankën Qëndrore janë llogaritur si më poshtë:

- LEK: 70% mbi normat e marrëveshjeve të riblerjes: 1.25% në vit për 31 dhjetor 2016 (31 dhjetor 2015: 1.225% në vit);
- USD: 0.00% në 31 dhjetor 2016 (31 dhjetor 2015: 0.00% në vit);
- Euro: -0.04% në 31 dhjetor 2016 (31 dhjetor 2015: 0.00% në vit).

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 7. Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare

Huatë dhe parapagimet ndaj institucioneve financiare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Rezidentë		
Hua ndaj institucioneve financiare	1,300,415	1,278,661
Jo rezidentë		
Llogari escrow për garanci bankare	12,817	12,579
<b>Totali</b>	<b>1,313,232</b>	<b>1,291,240</b>

#### 8. Investime të vlefshme për shitje

Investimet e vlefshme për shitje në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Bono thesari (8.1)	-	2,869,005
Obligacione qeveritare (8.2)	19,622,279	17,126,344
<b>Totali</b>	<b>19,622,279</b>	<b>19,995,349</b>

##### 8.1 Bono thesari

Më 31 dhjetor 2016 Banka nuk ka ekspozim në Bono thesari, si pasojë e stimulit monetar të normës bazë, duke pësuar një rënie materiale prej 96 pikë bazë në gjysmën e parë të vitit 2016.

Bonot e thesarit sipas maturimit kontraktual më 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015				
Maturitet	Vlera Nominale	Prim / (Skonto)	Interes i përllogaritur	Diferencë rivlerësimi	Vlera e mbartur
3 Mujore	-	-	-	-	-
6 Mujore	-	-	-	-	-
12 Mujore	2,900,000	(92,039)	48,668	12,376	2,869,005
	<b>2,900,000</b>	<b>(92,039)</b>	<b>48,668</b>	<b>12,376</b>	<b>2,869,005</b>

Norma efektive e interesit të bonove të thesarit më 31 dhjetor 2015 ka qënë nga 3.03% në 3.53%.



## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 8. Investime të vlefshme për shitje (vazhdim)

##### 8.2 Obligacione qeveritare

Obligacionet qeveritare janë të detajuara si më poshtë sipas maturitetit:

Maturitet	31 dhjetor 2016				
	Vlera Nominale	Prim / (Skonto)	Interes i përlogaritur	Diferencë rivlerësimi	Vlera e mbartur
24 muaj	2,740,000	-	29,014	(5,598)	2,763,416
36 muaj	1,250,000	122	23,562	13,820	1,287,504
60 muaj	6,360,000	8,188	76,508	28,423	6,473,119
84 muaj	2,690,000	58,580	42,818	(25,182)	2,766,216
120 muaj	1,680,000	1,312	60,883	256,973	1,999,168
Euro Bond	2,569,370	(10,485)	19,833	224,359	2,803,078
24 muaj në Euro	1,517,822	126	11,831	-	1,529,778
	<b>18,807,192</b>	<b>57,843</b>	<b>264,448</b>	<b>492,795</b>	<b>19,622,279</b>

Maturitet	31 dhjetor 2015				
	Vlera Nominale	Prim / (Skonto)	Interes i përlogaritur	Diferencë rivlerësimi	Vlera e mbartur
24 muaj	3,580,000	92	39,115	9,024	3,628,230
36 muaj	1,086,667	1,388	26,028	5,463	1,119,545
60 muaj	5,790,000	10,801	83,878	(43,033)	5,841,645
84 muaj	1,000,000	-	20,526	28,502	1,049,028
120 muaj	1,680,000	1,504	60,883	59,986	1,802,373
Euro Bond	2,608,320	(13,403)	20,134	31,388	2,646,439
24 muaj në Euro	1,029,600	330	9,153	-	1,039,083
	<b>16,774,587</b>	<b>712</b>	<b>259,717</b>	<b>91,329</b>	<b>17,126,344</b>

Obligacionet qeveritare përfitojnë interes gjashtë mujor me një normë kuponit në 31 dhjetor 2016 ndërmjet 0.75% deri në 9.53% (31 dhjetor 2015: nga 4.57% deri në 5.72%). Gjatë 2016, Banka u bë pjesë e blerjes së Eurobond-it, me një investim prej 3,724 mijë Euro me një normë vjetore 0.75%. Gjatë vitit 2015 Banka investoi në obligacione të Qeverisë për shumën prej 19,000 mijë Euro me normë interesi vjetore 5.75%.

##### 8.3 Lëvizjet në investime të vlefshme për shitje

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në balancat e investimeve të vlefshme për shitje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, duke përfshirë blerjet dhe maturimet përgjate këtyre viteve:

	Lëvizjet në investime të vlefshme për shitje	
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Balanca në fillim të vitit</b>	<b>19,995,349</b>	<b>20,514,693</b>
Blerjet përgjatë vitit	4,047,566	11,459,171
Maturimet përgjatë vitit	(4,705,743)	(11,956,979)
Luhatjet në të ardhurat nga interesat	(67,214)	(16,414)
Luhatjet në vlerën e drejtë	389,090	52,816
Efektet e kurseve të këmbimit	(36,769)	(57,938)
<b>Balanca në fund të vitit</b>	<b>19,622,279</b>	<b>19,995,349</b>

Më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 Banka nuk zotëron letra me vlerë të mbajtura deri në maturim.

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto

##### 9.1 Kredi dhe paradhënie për klientët, neto

Huatë neto dhënë klientëve në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
Sipërmarrës privat dhe ndërmarrje	30,516,345	27,879,547
Individë	16,472,654	14,451,693
Interesi i përllogaritur	116,415	147,230
	<b>47,105,414</b>	<b>42,478,470</b>
Minus zhvlerësimin	(2,343,883)	(1,941,538)
<b>Totali</b>	<b>44,761,531</b>	<b>40,536,932</b>

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
Kreditë me këste	33,753,389	29,489,520
Paradhëniet	13,349,501	12,988,951
Karta krediti	2,522	-
<b>Totali</b>	<b>47,105,414</b>	<b>42,478,470</b>

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016, Banka ka fshirë nga librat 97 kredi (2015: 212 kredi) me një shumë prej 508,315 mijë Lek (2015: 667,553 mijë Lek).

Fondi i zhvlerësimit paraqitet i detajuar në tabelën më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
Zhvlerësimi për kreditë dhe paradhëniet	2,341,588	1,909,357
Zhvlerësimi për balancat debitore	2,295	32,181
<b>Totali</b>	<b>2,343,883</b>	<b>1,941,538</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)

##### 9.1. Kredi dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit të kredive dhe paradhënieve për klientët sipas klasave të kredive dhe paradhënieve, për çdo kategori zhvlerësimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë të detajuara më poshtë:

	Sipërmarrës privat dhe ndërmarrje	Kredi dhënë Individëve	Kredi hipotekore dhënë individëve	Total
<b>Balanca më 31 dhjetor 2014</b>	<b>1,164,744</b>	<b>244,088</b>	<b>158,798</b>	<b>1,567,631</b>
Zhvlerësimi për humbje nga kreditë dhe paradhëniet	789,224	168,142	163,743	1,121,109
Rrimarje të fondit të zhvlerësimit	(10,962)	(23,534)	(45,153)	(79,649)
Llogari të arkëtueshme të pambledhshëmë të fshira	(390,149)	(121,572)	(176,509)	(688,231)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	6,371	1,112	13,195	20,678
<b>Balanca më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,559,228</b>	<b>268,236</b>	<b>114,074</b>	<b>1,941,538</b>
Zhvlerësimi për humbje nga kreditë dhe paradhëniet	1,025,083	61,266	109,801	1,196,151
Rimarrje të fondit të zhvlerësimit	(242,727)	(2,381)	(40,383)	(285,491)
Llogari të arkëtueshme të pambledhshëm të fshira	(450,614)	(15,535)	(42,166)	(508,315)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	-	-	-	-
<b>Balanca më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,890,970</b>	<b>311,587</b>	<b>141,326</b>	<b>2,343,883</b>
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>				
Zhvlerësimi për klientët e zhvlerësuar individualisht	1,143,814	193,775	45,098	1,382,687
Zhvlerësimi për klientët e zhvlerësuar në grupe	415,414	74,460	68,976	558,851
	<b>1,559,228</b>	<b>268,236</b>	<b>114,074</b>	<b>1,941,538</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>				
Zhvlerësimi për klientët e zhvlerësuar individualisht	1,644,980	248,690	8,808	1,902,478
Zhvlerësimi për klientët e zhvlerësuar në grupe	245,991	62,897	132,518	441,406
	<b>1,890,970</b>	<b>311,587</b>	<b>141,326</b>	<b>2,343,883</b>
Vlera e kredive të identifikuar për tu zhvlerësuar individualisht, përpara zbritjes së zhvlerësimit individual	<b>2,925,637</b>	<b>220,655</b>	<b>357,966</b>	<b>3,504,258</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)

##### 9.2. Qiratë Financiare

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Investimi në kontratat e qirave financiare		
- Më pak se një vit	66,270	35,906
- Ndërmjet një dhe pesë vjet	736,960	625,144
- Mbi pesë vjet	8,481	23,254
	<b>811,712</b>	<b>684,304</b>
Minus të ardhurat e papërfituara	(81,912)	(73,670)
Investimi në kontratat e qirave financiare, neto	<b>729,799</b>	<b>610,634</b>
Minus zhvlerësimin për qiratë financiare	(41,573)	(18,130)
<b>Total</b>	<b>688,226</b>	<b>592,504</b>

Lëvizjet në zhvlerësim për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 për kontratat e qirave financiare janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Shuma në fillim të vitit</b>	18,130	43,515
Shtesa në zhvlerësim gjatë periudhës	25,423	1,561
Pakësime në zhvlerësim gjatë periudhës	(1,978)	(26,947)
<b>Shuma në fund të vitit</b>	<b>41,573</b>	<b>18,130</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe )

#### 10. Aktivet e trupëzuara, neto

	Ndërtesa	Kompjuterat dhe pajisje elektronike	Mobilje dhe pajisje zyre	Automjete	Investime në ambiente me qira	Punime në proces	Totali
<b>Kosto</b>							
<b>Në 31 dhjetor 2014</b>	<b>387,078</b>	<b>468,364</b>	<b>451,674</b>	<b>32,123</b>	<b>296,096</b>	<b>84,221</b>	<b>1,719,556</b>
Shtesa	-	11,667	9,651	8,813	18,509	64,894	<b>113,534</b>
Shitje	-	(3,345)	(9,265)	-	-	-	<b>(12,610)</b>
Transferime	-	19,904	1,022	-	-	(81,008)	<b>(60,082)</b>
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>387,078</b>	<b>496,590</b>	<b>453,082</b>	<b>40,936</b>	<b>314,605</b>	<b>68,107</b>	<b>1,760,398</b>
Shtesa	14,647	7,010	11,615	7,731	16,785	27,649	<b>85,438</b>
Pakësime	(18,592)	(59,996)	(5,721)	(11,640)	-	(902)	<b>(96,851)</b>
Transferime	31,143	20,470	(24)	-	-	(94,854)	<b>(43,266)</b>
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>414,276</b>	<b>464,074</b>	<b>458,951</b>	<b>37,028</b>	<b>331,390</b>	-	<b>1,705,720</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
<b>Në 31 dhjetor 2014</b>	<b>(58,577)</b>	<b>(413,604)</b>	<b>(368,898)</b>	<b>(25,933)</b>	<b>(258,519)</b>	-	<b>(1,125,531)</b>
Shpenzimi i vitit	(13,440)	(24,950)	(26,077)	(4,215)	(18,631)	-	<b>(87,313)</b>
Pakësime	-	3,392	8,487	-	-	-	<b>11,879</b>
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>(72,017)</b>	<b>(435,162)</b>	<b>(386,488)</b>	<b>(30,148)</b>	<b>(277,150)</b>	-	<b>(1,200,965)</b>
Shpenzimi i vitit	(13,407)	(26,657)	(21,020)	(5,361)	(17,755)	-	<b>(84,199)</b>
Pakësime	3,709	57,637	5,362	11,575	-	-	<b>78,282</b>
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>(81,715)</b>	<b>(404,181)</b>	<b>(402,146)</b>	<b>(23,934)</b>	<b>(294,904)</b>	-	<b>(1,206,881)</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>							
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>315,061</b>	<b>61,428</b>	<b>66,594</b>	<b>10,788</b>	<b>37,455</b>	<b>68,107</b>	<b>559,433</b>
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>332,561</b>	<b>59,893</b>	<b>56,806</b>	<b>13,094</b>	<b>36,486</b>	-	<b>498,838</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 11. Aktivet e patrupëzuara, neto

	<b>Programe kompjuterike</b>
<b>Kosto</b>	
<b>Në 31 dhjetor 2014</b>	<b>455,910</b>
Shtesa	3,772
Transferime	60,083
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>519,765</b>
Shtesa	11,561
Transferime	43,266
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>574,592</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
<b>Në 31 dhjetor 2014</b>	<b>(232,244)</b>
Shpenzimi i vitit	(47,389)
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>(279,633)</b>
Shpenzimi i vitit	(54,014)
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>(333,647)</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>	
<b>Në 31 dhjetor 2015</b>	<b>240,132</b>
<b>Në 31 dhjetor 2016</b>	<b>240,945</b>

#### 12. Aktivet e mbajtura për shitje

Më 31 dhjetor 2016, Banka ka regjistruar në pasqyrat financiare aktive të mbajtura për shitje në vlerën 104,314 mijë Lek që përbëhet nga vlera e tre pronave të mara në rrugë ligjore për të cilat Banka është në proces shitje. Banka ka nënshkruar kontratat me blerësit dhe shuma e parapaguar prej 25,221 mijë Lek është depozituar në Bankë përpara datës së mbylljes së bilancit. Shuma e parapaguar është paraqitur si detyrim që lidhet me aktivet e mbajtura për shitje. Transaksioni i shitjes të aktiveve të mbajtura për shitje pritet të përfundojë në 2017.

#### 13. Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore

Më 31 dhjetor 2016 aktivet të marra në pronësi nga çështje gjyqësore prej 582,170 mijë Lek (31 dhjetor 2015: 1,125,712 mijë Lek) përfaqësojnë aktive të përfituara nga ekzekutimi i kolateraleve të kredive me probleme. Vlerat e prezantuara paraqesin vlerën më të vogël ndërmjet vlerës së mbartur dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
<b>Balanca hapëse</b>	<b>1,292,677</b>	<b>1,001,435</b>
Shtesat përgjatë vitit	114,702	312,505
Pakësimet përgjatë vitit	(705,382)	(22,967)
Transferime përgjatë vitit	(14,428)	-
Efekti i kurseve të këmbimit	(244)	1,705
<b>Vlera bruto</b>	<b>687,325</b>	<b>1,292,677</b>
Zhvlerësim për humbje nga rivlerësimi	(166,967)	(99,441)
Shtesat përgjatë vitit	(134,584)	(67,526)
Rimarje përgjatë vitit	196,396	-
<b>Fondi i zhvlerësimit</b>	<b>(105,155)</b>	<b>(166,967)</b>
<b>Vlera neto e aktiveve të mara në rrugë ligjore</b>	<b>582,170</b>	<b>1,125,712</b>

## BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 13. Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore (vazhdim)

Politika e Bankës për fshirjen nga librat e veta të aktiveve të përfituara në rrugë ligjore është atëherë kur banka nuk ka më pritshmëri për gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet shitjes, përdorimit apo dhënies me qira të tyre.

Politika që Banka ndjek për shitjen e aktiveve të përfituara me rrugë ligjore është duke vlerësuar ofertat e marra prej palëve që kanë shprehur interes në blerjen e tyre. Banka pasqyron gjithë aktivet e riposeduara në faqen e saj të internetit, që është e aksesueshme nga të gjithë përdoruesit, dhe jep informacion të mjaftueshëm për çdo aktiv që Banka zotëron dhe që ka për qëllim t'i shesë. Banka ka krijuar një Komitet, i cili mblidhet çdo muaj për të diskutuar mbi zhvillime të reja në tregun e pronave të paluajtshme, mundësitë që ekzistojnë për shitjen e aktiveve dhe ofertat e marra. Nëse Banka merr një vendim, kryhen negociata të mëtejshme mbi çmimin e shitjes së aktivit.

#### 14. Aktivet e tjera

Aktivitet e tjera në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Debitorë	59,177	161,820
Parapagime	30,437	34,030
Inventar	1,311	24,737
Llogari kleringu	228,333	105,088
- për veprimet me Money Gram	4,064	8,284
- për veprimet me ATM-të	11,746	5,015
- për veprime operacionale	170,931	1,265
- për veprime operacionale të tjera	41,592	-
- për veprime me kontratat e qirasë financiare	-	90,524
<b>Totali</b>	<b>319,258</b>	<b>325,675</b>

Më 31 dhjetor 2016 banka mban në llogari kleringu për veprime operacionale shumën prej 170,931 mijë Lek që përbëhet nga pagesa për shitjen e aktiveve të mara në rrugë ligjore në llogaritë e noterëve deri në finalizimin e procesit të shitjes.

#### 15. Detyrime ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<b>Depozita me afat</b>	<b>1,910,161</b>	<b>2,072,041</b>
Rezidente	1,910,161	2,072,041
Jo rezidente	-	-
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>39,744</b>	<b>374,120</b>
Rezidente	39,744	330,874
Jo rezidente	-	43,246
<b>Marrëveshje riblerje me Bankën Qëndrore</b>	<b>4,456,427</b>	<b>328,491</b>
<b>Hua nga bankat</b>	<b>1,223,200</b>	<b>2,165,520</b>
Rezidente	1,223,200	2,165,520
Jo rezidente	-	-
<b>Totali</b>	<b>7,629,534</b>	<b>4,940,172</b>

## **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**

### **Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

